



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, 27. 11. 2018

VENDIM

Nr. 29, datë 27. 11. 2018

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT DY VJECAR
"SEKRETAR ADMINISTRATIV DHE MBIKËQYRËS ZYRE"
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" neni 49 pika 1, neni 72 pika 1, VKM Nr.418, datë 10.05.2017 "*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre*", Udhëzimin Nr. 31, datë 29.12.2017 "*Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë*" si dhe në Vendimin Nr.79, datë 23.11.2018 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27.11. 2018

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ri të studimeve dy vjeçar "Sekretar administrativ dhe mbikëqyrës zyre" në Fakultetin e Shkencave Humane, Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letersisë.
2. Një kopje e këtij vendimi së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Rezana Vrapi- Kryetare

Florian Nurce- Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj- Anëtar

Dr. Enida Pulaj- Anëtar

Dr. Marinela Muço- Anëtar